



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 72

Prishtinë, më 11 mars 2013, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Behar Selimi, Mufera Shinik, Ardian Gjini, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Gëzim Kelmendi, Arsim Bajrami, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivković.

Mungoi: Arben Gashi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Blerta Aliu – Koha ditore; Jeton Bytyçi, Lejla Selimi, Petrit Hysaj – OSBE; Artan Canhasi – EULEX; Lumnije Murati – ZPRK; Labinot Lapashtica – UNDP dhe Burbuqe Berisha e Rebeka Maliqi – praktikante.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Behar Selimi, nënkryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.02.2013;
3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të grupit të punës në Projektligjin për provimin e jurisprudencës;
4. Shqyrtimi i raportit plotësues i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-145 për Organet qeveritare, për shoqërinë e informacionit;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.02.2013

Kryesuesi konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 11.02.2013, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të grupit të punës në Projektligjin për provimin e jurisprudencës

Armend Zemaj – Në cilësi të kryesuesit të grupit të punës, arsyetoi punën dhe amendamentet e propozuara nga grupi. Ai tha se, së bashku me ekspertët dhe propozuesin, kemi shqyrtuar Projektligjin për provimin e jurisprudencës dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit që t'i përkrahin amendamentet e propozuara, përveç amendamentit 5.

Nenet tjera të propozuara nga grupi i punës, kanë për qëllim plotësimin e kushteve, kriterëve, organizimit dhe kemi marrë modelet më të mira për ta forcuar këtë Projektligj dhe për ta sforcuar ligjin që është në fuqi. Arsyeja pse ne e kemi lënë që ta diskutojmë në Komision, ka qenë se shumica e anëtarëve të grupit të punës kanë qenë kundër nenit 5. Pra, që doktorët e shkencave, në mënyrë automatike të pajisen me këtë licencë. Ai dha sqarimet për amendamentin 5 dhe argumentoi pse edhe doktorët e shkencës duhet t'i nënshtrohen këtij provimi.

Haki Demolli – Në cilësi të anëtarit të grupit të punës, shprehu mendimin e tij duke thënë se i takon po kësaj kategorie që ka titullin e shkencave juridike, por në të njëjtën kohë nuk e ka edhe provimin e jurisprudencës dhe mendon se ata të cilët e fitojnë titullin e doktoratës, automatikisht mos ta fitojnë provimin e jurisprudencës. Ekziston një tendencë dhe kemi shumë të atillë që janë edhe në studimet master në noteri, por edhe në judikaturë, ku në të shumtën e rasteve, i lënë anash detyrimet e tyre primare për t'u pajisur me diploma, të cilat i shfrytëzojnë më tepër për interesa personale, sesa për ato shoqërore.

Arsim Bajrami - Dha disa argumente pse nuk duhet të jetë në mënyrë automatike provimi i jurisprudencës dhe pse nuk duhet të konsumohet në titullin e doktorit të shkencës. Titulli doktor i shkencave dhe master i shkencave, është titull akademik, ndërsa provimi i jurisprudencës është provimi shtetëror, ku Qeveria i cakton standardet për juristët e diplomuar që të anëtarësohen në funksionet gjyqësore. Ndër të tjera, ai tha se si mësimdhënës mund të jenë teoricienë të mirë, por nuk duhet dhënë përparësi për fitimin e licencës që të jenë edhe prokurorë, edhe gjyqtarë në mënyrë automatike, sepse nëse kanë përvojën e punës që paraqet ky Projektligj për provimin e jurisprudencës, automatikisht mund edhe që të zgjidhen gjyqtarë të Gjykatës Supreme. Vlerësoi se ne duhet të ngremë edhe më tepër kriterin për provimin e jurisprudencës, në mënyrë që të kemi edhe gjyqtarë, edhe prokurorë të fortë. Nëse i shohim disa doracakë, atëherë 80 % kanë pjesë teorike dhe vetëm 20 % pjesë praktike. I bashkohen mendimit të Haki Demollit, që mos të kenë këto privilegje.

Albulena Haxhiu – Tha se për provimin e jurisprudencës është debatuar edhe në seancën plenare dhe kemi kërkuar që të forcohen sa më shumë kushtet për dhënien e provimit të jurisprudencës. Pajtohem me parafolësit, që mos të jetë në mënyrë automatike provimi i jurisprudencës për doktorët e shkencës.

Halit Krasniqi – Pajtohem me parafolësit e mi, pra që mos të fitohet provimi i jurisprudencës në mënyrë automatike, sepse doktorëve të shkencave, do t'u ruhet në mënyrë automatike e drejta e provimit të jurisprudencës.

Ardian Gjini – U pajtua me parafolësit, që të hiqet në tërësi neni 5, duke pasur parasysh atë që u tha nga parafolësit, sepse doktoratat sot është lehtë të merren.

Kryesuesi – Tha se profesionin e avokatit e konsideron zanat, sepse titulli shkencor është titull i teoricienëve. Gjithashtu, ai mendon se ata që janë doktorë të shkencave, nuk duhet të kenë frikë nga provimi i jurisprudencës, sepse nëse titullin shkencor e kanë real, do ta kalojnë edhe provimin e jurisprudencës pa problem.

Kryesuesi, pas debatit, konstatoi se Komisioni për Legjislacion, në mënyrë unanime nxori këtë

Përfundim

I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit për Legjislacion.

II. I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës të miratojë Projektligjin për provimin e jurisprudencës, me amendamentet e propozuara.

III. Amendamentet e miratuara janë paraqitur si aneks i këtij procesverbali.

4. Shqyrtimi i raportit plotësues i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-145 për Organet qeveritare, për shoqërinë e informacionit

Kryesuesi – Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamentet të Komisionit Funkcional, në Projektligjin për organet qeveritare, për shoqërinë e informacionit dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen, nëse kanë vërejtje.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Legjislacion, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

1. Projektligjin nr. 04/L- 145 për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryesuesi i Komisionit

Behar Selimi